

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.24/2018	Data: 29.03.2018	

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) dhe neni 40 paragrafi 40.2 pika e) të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) dhe në pajtim me nenin 33. Paragrafi 33.1. pika 11) të Statutit të Komunës 01 Numër 62/10. dhe në bazë të nenit 3 paragrafi 1.3 dhe pika 1.11, neni 5 paragrafi 1, 2 dhe 3 si dhe neni 7 paragrafi 3 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale, Nr. 04/L-144, dhe Rregulloren QRK nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës, në mbledhjen e mbajtur më: 29.03.2018, shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim të patundshmërisë komunale afatshkurtër mori:

V E N D I M

PARAPRAK PËR DHENJËN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE

1. Sipërfaqja prej 19110m² nga njësia kadastrale nr: 00074-10, në zonën kadastrale Vrellë, e evidentuar me numër të certifikatës 247/2018 si Pronë shoqërore – shfrytëzues e mirë e fshatit Vrellë, të epet në shfrytëzim afatshkurtër, për shfrytëzimin e gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim.
2. Afati kohor për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme është 15 vite.
3. Obligohet Komisioni Vlerësues për dhënien e pronës në shfrytëzim, të zbatojë procedurat e cekur në Pikë I të këtij Vendimi, përmes ankandit publik, në pajtim me Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale, Nr.04/L-144 dhe Rregulloren QRK nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës.
4. Pas marrjes së Vendimit, mbi përzgjedhjen e kompanisë, nga Komisioni vlerësues, në pajtim me procedurat e Ligjit dhe Rregullores QRK nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës, Kryetari i Komunës do të lidhë kontratë me kompaninë e përzgjedhur më të cilën përcaktohen të drejtat dhe obligimet e kompanisë.
5. Obligohet Drejtorati për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, që pas përzgjedhjes së kompanisë, nga Komisioni vlerësues, të bëjë përkufizimin e sipërfaqes së cekur në Pikën I të këtij Vendimi.
6. Ky vendim hynë në fuqi shtatë ditë pas publikimit të tij në ueb faqen e Komunës, për realizimin e ti ngarkohet Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Urbanizëm Kadastër dhe mbrojtje të Mjedisit, dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit.



 REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
 KOMUNA E ISTOGUT - OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHVE
 UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
 Dales-Izlazna
 Nr. 01-039-3 Data 05.4-2018
 Istog-Istok

KRYESUESI I KUVENDIT

z. Qaush Balaj

(Signature)

